

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## SikaSwell® S-2

### IZOLUES POLIURETANI HIDROFIL DHE I BYMUESHËM

#### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaSwell® S-2 është izolues hidrophil poliuretani me 1 përbërës i cili bymehet në kontakt me ujin për të izoluar të gjitha llojet e fugave të ndërtimit dhe depërtimet në beton.

#### PËRDORIMET

Izolim:

- Fugat e ndërtimit
  - Depërtimet e tubave dhe shufrave metalike nëpërmjet mureve dhe pllakës së dyshemesë
  - Përreth të gjitha llojeve të depërtimeve dhe fugave ndërtimore
  - Fugat e ndërtimit në kanalinat e kablove, etj.
- Fiksimit / ngjitje e profileve të bymueshme:
- Tubat për injektimin e SikaFuko® Swell 1
  - Profilet SikaSwell®-A
  - Profilet SikaSwell®-P

#### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Aplikim i lehtë
- Ndërkapje e mirë mbi nënshtresa të ndryshme
- Shkallë bymimi e optimizuar, pra nuk dëmtohet betoni i freskët gjatë maturimit
- Produkt shumë ekonomik
- Bymehet në kontakt me ujin
- Rezistencë e përhershme ndaj ujit
- Mundësi adaptimi për t' u përshtatur me lloje të ndryshme detajesh

#### MIRATIME / STANDARDE

- Certifikatë Agrément, Waterstop-e hidrophile Sika, BBA, Certifikatë Nr. 3-4994
- Raport testimi, Testim i papërshkueshmërisë nga uji i waterstop-it hidrophil, Vattenfall, Raport Nr.1278-10
- Raport testimi, Testi i përshkueshmërisë së ujit, Hong Kong Testing Co Ltd, Raport Nr.S016410M01064

#### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	poliuretan me 1 përbërës, maturohet me lagështinë	
<b>Ambalazhi</b>	sallam 600 ml	20 copë/ kuti, 48 kuti/ paletë
	tubetë 300 ml	12 copë/ kuti, 112 kuti/ paletë
<b>Paraqitja / Ngjyra</b>	E kuqe oksidi	
<b>Jetëgjatësia</b>	9 muaj nga data e prodhimit	
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +25°C. Referohuni gjithmonë tek ambalazhi.	
<b>Dendësia</b>	1,33 kg/l (në 23°C)	(ISO 2811)

## TË DHËNA TEKNIKE

<b>Fortësia Shore A</b>	Bymim (7 ditë në ujë çezme)	> 10	(DIN 53505) (EN 868)
	Pa bymim (7 ditë / +23°C / 50% lagështi relative)	40–60	
<b>Ndryshimi i vëllimit</b>	1 ditë në ujë çezme	< 25 %	(DIN 53521)
	7 ditë në ujë çezme	< 100 %	(EN 14406)
Vetitë e bymimit në ujë të kripur do të reduktohen dhe vonohen.			

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

<b>Rrjedha e varjes</b>	<2 mm	(ISO 7390)	
<b>Konsumimi</b>	<b>Madhësia e prerjes së majës së fishekut</b>	<b>sallam 600 ml</b>	<b>tubetë 300 ml</b>
	15 mm	6,2 m	3,1 m
	20 mm	3,6 m	1,8 m
Konsumimi varet nga ashpësia dhe absorbueshmëria e nënshtresës. Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.			
<b>Lagështia e përmbajtur e nënshtresës</b>	E thatë ose e lagësht mat		
<b>Ritmi i maturimit</b>	1 ditë (+23°C / 50% lagështi relative)	~2,0 mm	(CQP 049-2)
	10 ditë (+23°C / 50% lagështi relative)	~10,0 mm	
<b>Koha e krijimit të kores</b>	2 orë (+23°C / 50% lagështi relative)	(CQP 019-1)	
<b>Temperatura e mjedisit</b>	+5 °C min. / +35 °C max.		
<b>Temperatura e nënshtresës</b>	+5 °C min. / +35 °C max.		

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër, e thatë ose e lagësht mat dhe pa asnjë kontaminues të sipërfaqes.

### PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

#### Beton ekzistues

Të gjitha grimcat e lira, disarmantët, korja e çimentos (qumështi), boja, ndryshku dhe materiale të tjera të lira duhet të hiqen me përgatitje të përshtatshme manuale ose mekanike.

#### Beton i freskët

Gjatë betonimit, kompaktimi mirë përreth SikaSwell® S-2 për të patur një beton të ngjeshur pa hoje apo vrima.

Sipërfaqet të cilat janë shumë të ashpra mund të jenë subjekt i rrjedhjes. Rekomandohet nivelimi i betonit të freskët të derdhur me një dërrasë aty ku do të vendoset izoluesi.

### METODA E APLIKIMIT / MJETET

#### Aplikimi i izoluesit SikaSwell® S-2 për fiksion

Aplikoni SikaSwell® S-2 në një shirit të hollë (madhësia e prerjes së majës trekëndore ~5 mm) mbi nënshtresën e përgatitur. Nxirrni sasi të mjaftueshme për të niveluar ashpërsinë e nënshtresës.

#### Aplikimi i profileve dhe i tubit për injektim

Ngjeshni profilet SikaSwell®-A dhe P ose tubin e injektimit SikaFuko® Swell 1 tek SikaSwell® S-2 i sapoaplikuar derisa të dalë një sasi e vogël nga të dyja anët e profilit/ tubit për të arritur një ngjitje të plotë me sipërfaqen. Profilet duhet të vendosen brenda max. 30 minutave. Lejoni që SikaSwell® S-2 të ngurtësohet për 2-3 orë përpara hedhjes së betonit. Mbroni profilet SikaSwell® S-2 nga uji (p.sh. shiu) derisa të hidhet betoni.

#### Izolues i mbuluar për fugën e ndërtimit

Përdorni një fishek trekëndor ose priteni fishekun që materiali të dalë në formë trekëndëshi dhe aplikoni SikaSwell® S-2 sipas tabelës së mëposhtme:

Trashësia e strukturës:	Madhësia e prerjes në formë trekëndëshi:
< 30 cm	15 mm

Vendosni SikaSwell® S-2 në qendër të seksionit të betonit. Mbroni SikaSwell® S-2 nga uji (p.sh. shiu) derisa të hidhet betoni.

## MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me Sika® Colma-Cleaner. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## KUFIZIME

- Sigurohuni se është arritur një kontakt i plotë dhe i vazhdueshëm ndërmjet profileve SikaSwell® S-2 dhe nënshtresës.
- Mbulimi minimal i izoluesit në të dyja anët duhet të jetë 10 cm (beton i armuar) ose 15 cm (beton pa armim).
- Për lartësi hedhjeje < 50 cm lejoni që izoluesi të ngurtësohet për 2-3 orë. Nëse lartësia e hedhjes është > 50 cm, SikaSwell® S-2 duhet të ngurtësohet për të paktën 2 ditë.
- SikaSwell® S-2 zgjerohet në kontakt me ujin. Zgjerimi nuk është i menjëhershëm dhe mund të zgjasë disa orë. Këshillohet që SikaSwell® S-2 të mos lihet në ujë të ndenjtur për shumë kohë (max. 24 orë nëse bëhet drenazhim i ujit).
- Mos përdorni SikaSwell® S-2 për fugat e lëvizjes.
- Nëse niveli i ujit rritet papritmas, papërshkueshmëria e fugave nga uji do të arrihet kur SikaSwell® S-2 të jetë bymuar.
- Në gjendje totalisht të thatë, SikaSwell® S-2 tkurret në përmasat e tij origjinale dhe pastaj bimehet sërish në kontakt me ujin.
- Megjithëse SikaSwell® S-2 është testuar për presion uji deri në 5 bar, nuk rekomandohet për izolim kundër ujit në presion më të lartë se 2 bar për shkak të distancës së kufizuar të izolimit. Për presione > 2 bar, SikaSwell® S-2 mund të përdoret për fiksimin e tubave për injektim SikaFuko® Swell 1 ose si një masë plotësuese izolimi për Sika® Waterbars.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaSwell® S-2

Shkurt 2019, Botimi 01.01

020703300110000001

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.